

INFORMACION NË LIDHJE ME KOMISIONET E APLIKUARA PËR VEPRIMET E LETRAVE ME VLERË NGA RAIFFEISEN BANK ALBANIA

1. Nëse një klient blen një bono thesari / obligacion thesari (në monedhë vendase ose të huaj EUR apo USD) në tregun primar pranë bankës sonë (nëpërmjet pjesëmarrjes në ankand) komisioni që aplikohet për individët është:

| INFORMACION PER KOMISIONET E APLIKUARA NGA BANKA RAIFFEISEN: | LEK | EUR | USD |
|---|---|--|---|
| Pjesëmarrja në Ankandet e Tregut Primar të Letrave me Vlerë emetuar nga Qeveria e Shqipërisë për Klientët Individë nepermjet RBAL dhe për Klientet e BoA. | 0.20% e shumës së investuar. Min: 1,000 LEK - maksimumi 10,000 LEK | 0.20% e shumës se investuar. Min:10 EUR - maksimumi 100 EUR | 0.20% e shumës së investuar. Min: 10 USD - maksimumi 100 USD |

Shembuj:

1. Nëse një klient dëshiron të investojë pranë bankës sonë një shumë 1,500,000 lekë në një bono thesari 12 mujore në ankandin e tregut primar atëherë do të paguajë komisionin si me poshtë:

| |
|--|
| $1,500,000 \times 0.20\% = 3,000 \text{ lekë}$ |
|--|

2. Nëse klienti merr pjesë më 300,000 lekë atëherë 0.20% do të ishte 600 lekë, por klienti paguan 1,000 lekë komision sepse bazuar tek tabela e mësipërme ai është komisioni minimum.
3. Nëse klienti merr pjesë më 10,000,000 lekë atëherë 0.20% do të ishte 20,000 lekë por klienti paguan vetëm 10,000 lekë komision sepse bazuar tek tabela e mësipërme ka një maksimum të komisionit.
4. Raiffeisen Bank blen / shet bono dhe obligacione thesari me maturime të ndryshme klientëve në tregun me pakicë dhe për këtë **nuk aplikon asnjë komision**. Çmimi i blerjes / shitjes së letrës me vlerë përcaktohet nga yield-i dhe ditet e mbetura deri në maturim të letrës me vlerë. Sipas rregulloreve përkatëse duhet që letra e tregtuar të ketë minimum një ditë deri në maturim.

Shembuj:

- Një klient do të investojë pranë Bankës Raiffeisen në tregun me pakicë, një shumë 1,000,000 lekë në një Bono Thesari 12 mujore, me ditë të mbetura deri në maturimi 357, duke pasur parasysh që yield-i në shitje i kuotuar nga banka është 1.80%, çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$\zeta_b = \frac{V_n}{1 + \frac{y}{365} \times D} \quad \text{ku,}$$

ζ_b - çmimi i blerjes

V_n - vlera nominale

y - *yield* (norma e interesit) i shprehur në bazë vjetore

D - ditët deri në maturim

$$\text{Çmimi i bonos} = 1,000,000 / (1 + 1.80\%/365 * 357) = 982,699.11$$

- Në rastin kur klienti dëshiron të shesë një letër me vlerë të Qeverisë, pranë bankës Raiffeisen, para datës së maturimit me ditë të mbetura deri në maturim më shumë se 1, Raiffeisen Bank nuk aplikon komision. Në këtë rast, çmimi i blerjes së letrës me vlerë të Qeverisë do të llogaritet në bazë të *yield*-it të blerjes të kuotuar nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim duke përdorur të njëjtën formulë si më lart.
- Obligacionet e thesarit shiten me premium/discount ndaj vlerës së tyre nominale. Investitori në ditën e blerjes paguan vetëm çmimin e blerjes (Vlere nominale +/- prem/discount + interesat e akumuluar). Keto përcaktohen si llogaritje e të gjithë faktorëve në përputhje me vlerën nominale dhe normën *Yield-in*, i cili përcaktohet nga banka. Kuotimet per *yieldin* e Obligacioneve të thesarit luhaten në varesi të tregut.